



Datë: 04.08.2025

Numër Protokolli: 5241/2025

A.nr.974/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtar, me Sabile Avdyli, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.974/2025, të datës 27.05.2025, të parashtruar nga ankuesi S.B, kundër organit të punësimit: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.974/2025, e datës 27.05.2025, e parashtruar nga ankuesi S.B.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 08.05.2025, për përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër Reference RN00017199, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm*”, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Ankuesi, S.B (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), kandidat për praninë sipas Konkursit me numër Reference RN00017199, të shpallur më datë 19.03.2025 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm*”, më datë 22.05.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3495/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.974/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndaj zhvillimit të kësaj procedure rekrutimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa kjo e fundit me datë 14.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave (*në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit*) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3495/2025 të datës 27.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 08.05.2025; Dokument identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 17.06.2025; Konkursin me numër

reference RN00017199 të datës 19.03.2025; Njoftimi i datës 29.04.2025; Lista përfundimtare e vlerësimit të kandidatëve e datës 08.05.2025; Vendimin me Nr.158/2025 të datës 02.05.2025, për themelimin e Komisioni të Pranimit; Akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; E-mailin e datës 06.05.2025; Testin me shkrim të datës 08.05.2025; Formularët e vlerësimit të eses; Aplikacionin e datës 20.03.2025, së bashku me dokumentacionin e bashkangjitur për konkursin përkatës; Aplikacionin e ankuesit të datës 17.04.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Nga provat e administruara të lëndës rezultojnë se Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 19.03.2025 ka shpallur Konkursin publik me numër reference RN00017199, për pozitën e Kategorisë së Ulët Drejtuese, “*Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm*”, ku afati për aplikim ka qenë nga data 20.03.2025 deri më 18.04.2025.

Rrjedhimisht, sipas Njoftimit të datës 29.04.2025, të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, rezultojnë se kriteret i kanë plotësuar dhe kanë hyrë në listën e ngushtë katër (4) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili ka marrë pjesë në vlerësimin e testit me shkrim duke arritur gjithsejtë 46.2 pikë përgjithshme, të pamjaftueshme për të vazhduar tutje me fazën e vlerësimit final atë të intervistës me gojë.

Tutje, sipas Listës përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve të datës 08.05.2025, rezultojnë se asnjë nga dy kandidatët pjesëmarrës në fazën e testit me shkrim duke përfshirë këtu edhe ankuesin, nuk ka arritur të kalojë pragun e kalueshmërisë prej 50 % të pikëve për të vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë, si rrjedhojë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 08.05.2025 ka publikuar Njoftimin, sipas të cilit njoftim rezultojnë se procedura e rekrutimit me numër reference RN00017199, për pozitën e punës “*Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm*”, ka përfunduar për arsye se asnjë kandidatë nuk ka arritur pragun e kalueshmërisë nga testi me shkrim.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon për se testi me shkrim ka përmbajtur gabime përmbajtjesore dhe gjuhësore që kanë ndikuar negativisht në vlerësimin e kandidatëve, ka pasur ndërhyrje në testin me shkrim duke krijuar mos përputhje të dukshme ndërmjet kërkesave të përshkrimit të pozitës dhe përmbajtjes reale të pyetjeve të testit me shkrim, prani të pyetjeve të papërpunuar profesionalisht, që tregojnë mungesë të standardeve teknike dhe metodologjike në hartimin e testeve, mos respektim të orarit dhe kushteve të provimit, po ashtu i njëjti thekson se Komisioni i Vlerësimit është devijuar nga parimet e drejtësisë dhe barazisë, andaj kërkon verifikim të pavarur të testit me shkrim, rivlerësim të pikëve dhe vendimmarrjes lidhur me anulimin e konkursit si dhe shqyrtimin e pamjeve apo kamerave të sigurisë.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses i ’u referuar dispozitave ligjore të nenit 44 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik, lidhur me pranimin e kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, ku përcaktohet se: 5. *Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 5.1. verifikimi paraprak, përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët/ët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkursit; dhe 5.2. vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidateve/ëve. 6. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional kryhet nga komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese. 7. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i*

konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë.; si dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, përkatësisht nenit 8, i cili përcakton se: Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga testi me shkrim dhe intervista dhe zhvillohet nga Komisioni i Pranimit me mbështetjen e NjMBNj.; nenit 9, ku përcaktohet se: 1. Vlerësimi nëpërmjet testimit me shkrim është hapi i parë i procesit të vlerësimit profesional të kandidatëve pas verifikimit paraprak, dhe duhet të realizohet më së largu 15 ditë pas publikimit të listës së kandidatëve që kanë kaluar verifikimin paraprak. 2. Në testimin me shkrim, kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme, të kërkuara për pozitën apo grupin e pozitës përkatëse. 3. Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri në shtatëdhjetë (70) pikë. 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim. 5. Komisioni i Pranimit në përbërje të plotë është i obliguar ditën e zhvillimit të testimit me shkrim të përzgjedhë nga bankat e pyetjeve që disponon Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara në shpalljen për rekrutim. 6. Testi me shkrim përmban gjithësej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 7. Kohëzgjatja e testimit me shkrim është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) minuta. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimit, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimit. 9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim. 10. Pas vlerësimit të testimit me shkrim, NjMBNj sipas rekomandimeve të Komisionit të Pranimit e përpilon listën e kandidatëve që e kanë kaluar testimin me shkrim. 11. Lista sipas paragrafit 10 të këtij neni bëhet publike nga NjMBNj në SIMBNj, faqen e institucionit si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit.; si dhe paragrafit 2 të nenit 10, i cili përcakton se: 2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë.

Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat ligjore të lartë theksuara dhe testit me shkrim të datës 08.05.2025, të përpiluar për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017199, për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm”, rezulton se i njëjti ka përmbajtur gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese, ndërsa vlerësimi i testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, dhe se pyetjet e testit kanë qenë të njëjta për gjithë kandidatët, ndërsa nga provat e pranuar nga ankuesi, si dhe organi i punësimin, rrjedh se ankuesja ashtu sikurse edhe kundër kandidati i saj S.B i janë nënshtruar testit me shkrim, mirëpo ankuesja në fazën e testimit me shkrim ka arritur t’i mbledh vetëm 46.8 pikë, respektivisht 34 pikë nga përgjigjet për pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë dhe 12.8 pikë prej 20 pikëve sa ishte maksimumi i pikëve për esenë me shkrim, nga rrjedh se e njëjta ashtu sikurse edhe kandidati S.B (46.2 pikë të arritura), nuk kanë arritur t’i marrin pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e kalueshmërisë dhe rrjedhimisht për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, gjegjësisht intervistën me gojë, sikurse parashihet me dispozitat e Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 9 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, ashtu që për sa më sipër nuk qëndron pretendimi ankimor i ankuesit se përmbajtja e testit ka gabime përmbajtjesore dhe gjuhësore që kanë ndikuar negativisht në vlerësimin e kandidatëve, sepse gabimet rezultojnë të jenë minimale tek tri pyetje dhe se të njëjtat nuk kanë reflektuar në ndryshimin përmbajtjesor të pyetjes së parashtruar, ndërsa vlerësimi i esesë sipas dispozitave ligjore në fuqi për procedurat e rekrutimit është në diskrecion të

Komisionit të Pranimit, si dhe po ashtu Kolegji thekson se pretendimi ankimor për shikimin e kamerave të sigurisë nuk është në mandat ligjor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga rrjedhë se në rastin përkatës nuk ka bazë ligjore pretendimi ankimor i ankuesit për rivlerësim.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, me rastin e publikimit të Njoftimit të datës 08.05.2025, lidhur me përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017199, për pozitën e punës “Udhëheqës i Divizionit Harmonizues për Auditimin e Brendshëm”, ka vërtetuar kështu drejtë gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me nenin 9 paragrafin 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për arsye se asnjë kandidatë nuk ka arritur pragun e kalueshmërisë prej 50 pikëve nga testi me shkrim për të vazhduar tutje me vlerësimin e intervistës me gojë, ashtu sikurse parashihet me nenin 9 paragrafin 2 të kësaj rregulloreje.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftimit i datës 08.05.2025, për përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00017199, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.974/2025**

Sabile Avdyli

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses S.B;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.